

## DËRGIMI I PËRKOSSHËM I VËRTETË

*Përditësimi i fundit 11 Mars 2025*

Inspektoriati shtetëror i punës dhe shërbimeve shoqërore është autoriteti që garanton zbatimin e dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, përshi ato për dërgimin e punëmarrësve të përkohshëm të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë (neni 1, L.9634/2006 “Për inspektimin e punës”, i ndryshuar). Disa nga elementët e dërgimit të përkohshëm të vërtetë (periudha e kufizuar kohore e qëndrimit në shtetin ku është dërguar, rikthimi pas përfundimit të punës ose shërbimit, natyra e aktiviteteve) janë shprehur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë (neni 3/1, Kodi i Punës).

Inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës, ndër të tjera, siguron zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë, që inspektorët e punës ngarkohen të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave. Misioni i përgjithshëm i Inspektoratit shtetëror që mbulon fushën e punës është kontrolli, konstatimi, këshillimi, njoftimi, formimi, zbutja e konflikteve, parandalimi dhe sanksionimi (neni 6, L. 9634/2006 “Për inspektimin e punës”, i ndryshuar).

Organi administrativ përgjegjës për përgatitjen e zbatimit e legjislacionit dhe politikës së punës është Ministri përgjegjës për punën (neni 199 i KP).

Në lidhje me elementët faktikë, që vërtetojnë dërgimin e përkohshëm të vërtetë dhe vlerësimin e kontrollin e tyre në mënyrë të posaçme, legjislacioni kombëtar është në përmirësim të vazhdueshëm me synimin për të arritur përafrim të plotë me Direktivën 2014/67/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit të 15 Majit 2014, mbi zbatimin e Direktivës 96/71/KE lidhur me dërgimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe që amendon Rregulloren (BE) nr.1024/2012 mi bashkëpunimin administrativ përmes Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm (“Rregullorja IMI”).